



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 623/4 prot.

Tiranë, më 15.9.2025

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr.33, datë 15.9.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË
PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË REZULTATEVE NË PUNË NË
PËRFUNDIM TË PERIUdhËS SË PROVËS DHE MOSKONFIRMIMIN SI
NËPUNËS CIVIL, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE BALDUSHK, BASHKIA
TIRANË DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR
PALIGJSHMËRINË E KONSTATUAR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të regjistruar pranë Komisionerit me shkresat nr.623 prot., datë 18.6.2025 dhe nr. 649 prot., datë 30.6.2025, të dërguara nga nëpunësja civile në periudhë prove Lusiana Plaku,

VËREJ SE:

Në përmbajtjen e informacionit të përcjellë nëpërmjet shkresave të dërguara, punonjësja Lusiana Plaku, ka parashtruar pretendimin se vlerësimi për periudhën e provës në nivelin “jokënaqshëm” (4) dhe vendimi për moskonfirmimin si “nëpunës civil” janë në kundërshtim me përcaktimet e vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar dhe kreut VI, të

vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar, duke arsyetuar se:

- Procesi i vlerësimit nuk mbështetet në kritere objektive të matshme të performancës;
- Përfshin si argumente penalizuese çështje të njëjta, për të cilat nëpunësja është ankuar zyrtarisht duke kërkuar mbrojtje ligjore;
- Nuk rezulton asnjë dokumentim gjatë periudhës së provës, i cili të ketë paralajmëruar nëpunësen lidhur me performancën e saj;
- Nëpunësja nuk është vënë në dijeni, përsa i përket rezultateve të certifikatës që vërteton përfundimin me sukses të programit të detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s, *“Prezantimi me Administratën Publike”*.

Me pretendimet si më sipër, nëpunësja i është drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke kërkuar verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera në përfundim të periudhës së provës, e cila është përmbyllur me moskonfirmimin si *“nëpunës civil”* dhe lirim nga shërbimi civil të nëpunëses L. Plaku.

Në këto rrethana, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara në përmbajtjen e informacionit në mbështetje të kompetencave ligjore të sanksionuara në ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, vlerësoi se ka dyshime të arsyeshme për parregullsi të lejuara gjatë administrimit të shërbimit civil, e në këto rrethana ka filluar procesin e verifikimit të informacionit nëpërmjet shkresës nr. 623/1 prot., datë 8.7.2025 *“Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, për nëpunësen Lusiana Plaku”*, duke vënë në dijeni institucionin e Bashkisë Tiranë dhe njësinë administrative Baldushk duke kërkuar edhe dokumentacionin përkatës.

Në vijim, me shkresën nr. 1163 prot., datë 11.7.2025, të njësisë administrative Baldushk, protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 623/2 prot., datë 14.7.2025, është dërguar dokumentacioni përkatës ku materializohet procedura e ndjekur gjatë periudhës së provës për punonjësen në fjalë, i cili duhet ta theksojmë paraprakisht se, nuk ishte i plotë,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, rezulton e provuar se kjo nëpunëse, me aktin nr. 22821, datë 11.6.2024 (*akti nuk është dërguar nga njësia administrative Baldushk, por është siguruar nga grupi i punës pranë Komisionerit që mbikëqyr Bashkinë e Tiranës*) është emëruar si nëpunëse civile në periudhë prove, në pozicionin *“Specialist Jurist”*, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, pranë njësisë administrative Baldushk, në Bashkinë Tiranë, nëpërmjet procedurës së konkurrimit në kategorinë ekzekutive, bazuar në nenin 22 dhe 23, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për*

pranimin, lëvizjen paralel, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar.

Në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe kreut VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive”*, nëpunësit civilë që emërohen për herë të parë në shërbimin civil, i nënshtrohen një periudhe prove që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit dhe gjatë kësaj periudhe nëpunësi është i detyruar të ndjekë:

- a) Programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s;
- b) Udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Nga përmbajtja e aktit të moskonfirmimit, që ka nxjerrë administratori i Njesisë Administrative Baldushk, rezulton se, nëpunësja Lusiana Plaku ka përfunduar me sukses programin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s, *“Prezantimi me Administratën Publike”*, por Çertifikata e marrë nga ASPA, nuk është dërguar si provë pranë Komisionerit, nga ana e njesisë administrative Baldushk.

Sa i takon kërkesës ligjore për caktimin e nëpunësit më të vjetër nën kujdestarinë e të cilit duhet të jetë nëpunësi në periudhë prove, parashikuar në germën b), të pikës 2, të kreut VI, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, nga dokumentacioni i administruar, rezulton se, nuk ka një akt konkret të eprorit direkt për caktimin e tij.

Ndërkohë, nga dokumentacioni i administruar, i dërguar nga njësia administrative, rezulton se, nëpunësja Y. Xhepa ka dhënë mendimin e saj me shkrim për nëpunësen Lusiana Plaku në përfundim të periudhës së provës, duke e vlerësuar performancën në punë të saj: *“një performancë jo e kënaqshme, pasi nuk ka përmbushur detyrat dhe ka treguar një sjellje jo të kënaqshme profesionale dhe aspak gadishmëri për të punuar në grup...”*. Kjo shkresë rezulton e paprotokolluar dhe nuk provohet sipas rregullave, koha kur është hartuar.

Duke vijuar më tej, me analizën e fakteve, në referim të pikës 6, të kreut VI, të Vendimit, nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimi në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar, vendimi në përfundim të periudhës së provës merret bazuar në:

- a) Rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA;
- b) Vlerësimin e rezultateve individuale në punë i cili bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore.

Sikurse u evidentua edhe më lart në material *(hapat që ndiqen gjatë periudhës së provës, pika 2, e kreut VI, të VKM-së 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar)*, nëpunësja L. Plaku ka

ndjekur tranimin e detyrueshëm pranë ASPA-s, por nuk na është vënë në dispozicion Certifikata e lëshuar nga ASPA, për të verifikuar nëse e ka kaluar atë me sukses.

Më tej, në zbatim të përcaktimeve të pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për *nëpunësin civil*”, i ndryshuar; germës b), pika 6, të kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për *pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar dhe germës b), pika 1, të kreut II, të vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për *vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, në kuadër të procesit të verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave dhe aftësive apo dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave gjatë periudhës së provës, është bërë vlerësimi për nëpunësen L. Plaku, dhe rezultojnë se:

- Vlerësimi i rezultateve në fund të periudhës së provës është kryer për periudhën 1 vjeçare, duke filluar nga data e emërimit 14.6.2024, deri në datën e vlerësimit, 27.6.2025;
- Zyrtarët që kanë marrë pjesë në vlerësim në rolin e Zyrtarit Raportues/Zyrtarit Kundërfirmues/Zyrtarit Autorizues janë përfaqësuar të gjithë nga Administratori i njësisë administrative Baldushk;
- Niveli i vlerësimit ka qenë “*jokënaqshëm*” (4).

Pas njohjes me vlerësimin për periudhën e provës në datën 27.6.2025, nëpunësja ka kërkuar rivlerësim nga ana e Zyrtarit Autorizues, duke përcaktuar në këtë rol administratorin e Njësisë Administrative. Pas këtij procesi, i cili rezultojnë të jetë kryer brenda ditës, Administratori në rolin e Zyrtarit Autorizues ka konfirmuar qëndrimin e tij, duke ruajtur të njëjtin nivel vlerësimi “*jokënaqshëm*” (4).

Në përmbyllje të procesit të vlerësimit të periudhës së provës për nëpunësen L. Plaku, konstatohet se Administratori i njësisë administrative Baldushk, ka marrë rolin e eprorit direkt të nëpunëses dhe me vendimin nr. 1068 prot., datë 27.6.2025 “Për *moskonfirmimin si nëpunëse civile*”, të nëpunëses Lusiana Plaku, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, ka vendosur moskonfirmimin e saj në këtë pozicion pune, duke argumentuar edhe arsyet për këtë qëndrim.

Në analizë të dispozitave ligjore që parashikojnë procesin e vlerësimit të rezultateve të punës, të normuara në VKM-në nr. 109, datë 26.2.2014, të ndryshuar, në pikën 2, të këtij akti nënligjor përcaktohen zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit. Referuar strukturës aktuale në njësinë administrative Baldushk, konstatohet se, si Zyrtar Raportues për nëpunëse L. Plaku, duhet të ishte nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative këtë nëpunëse, që korrespondon me Përgjegjësen e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse.

Nga dokumentacioni i administruar dhe në kuptim të dispozitës ligjore të sipërcituar, si dhe nenit 4, germa e), të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, në rastin konkret konstatohet se, në të

gjitha fazat e këtij procesi nuk janë përcaktuar drejt rolet e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin e punës dhe për konfirmimin e nëpunësit civil. Kjo parregullësi ka ardhur si rrjedhojë e një interpretimi dhe zbatimi të gabuar të legjislacionit të posaçëm për shërbimin civil nga ana e subjekteve që kanë kryer veprime administrative në zbatim të instituteve të ligjit për nëpunësin civil, pasi në këtë rast, atributet e eprorit direkt dhe zyrtarëve të vlerësimit të punës i janë dhënë Administratorit të Njesisë Administrative Baldushk, për nëpunësit civilë që ushtrojnë detyrën e tyre pranë kësaj njësie.

Në nenin 65, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 139/2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

1. “*Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori.*”
2. *Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës para tij për funksionimin dhe veprimtarinë e administratës.*”

Në vështrim të mënyrës se si fillon dhe përfundon marrëdhënia e punës për Administratorin, përcaktohet se ai nuk është subjekt i ligjit për shërbimin civil dhe për më tepër, nga përmbajtja e nenit 66, të po këtij ligji, në të cilën përmenden shprehimisht detyrat e administratës së njësisë administrative, nuk rezultojnë që Administratori të ketë kompetencë në administrimin e shërbimit civil, për njësitë administrative, e në këto kushte, ai nuk mund të marrë rolin e eprorit direkt ndaj nëpunësve civilë të njësisë administrative.

Mungesa e kompetencës së administratorit për të vepruar në cilësinë e eprorit direkt, për nëpunësit civilë të njësisë administrative, del edhe nga përmbajtja e nenit 4, germa “e”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, sipas së cilës me këtë cilësi paraqiten:

- i) *Titullari i institucionit për nëpunësit civil të kategorisë së lartë drejtuese, përfshirë nëpunësit në pozicionet e koordinatorit të posaçëm dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë;*
- ii) *Sekretari i përgjithshëm apo nëpunësi në pozicionin ekuivalent me të, për drejtorët e drejtorive dhe drejtuesit e degëve territoriale të institucionit;*
- iii) *Titullari i institucionit të varësisë për drejtorët brenda këtij institucioni;*
- iv) ***Drejtor i drejtorisë për të gjithë nëpunësit e pozicioneve të tjera;***

Nga analiza e dispozitës së mësipërme, rezultojnë se, në cilësinë e eprorit direkt për punonjësin e emëruar në pozicionin e punës “*Specialist*”, paraqitet zyrtari i cili kryen detyrën e “*Drejtorit të Drejtorisë*”.

Referuar strukturës aktuale të njësisë Administrative Baldushk, rezultojnë se, kjo njësi është e organizuar në nivel sektori dhe pozicioni i “*Drejtorit të Drejtorisë*”, nuk është parashikuar në strukturë, megjithatë, mungesa e këtij pozicioni në strukturën e njësive administrative

nuk legjitimon administratorin të paraqitet në cilësinë e eprorit direkt, për nëpunësen L. Plaku.

Njësitë administrative, nuk janë subjekte që veprojnë më vete, por janë pjesë e strukturës së Bashkisë Tiranë, e në këto rrethana, pozicioni “Specialist”, në njësinë administrative, duhet të ketë në rolin e “eprorit direkt”, punonjësin i cili mban rolin e “Drejtorit të Drejtorisë”, në njësinë organizative në Bashkinë Tiranë, pranë të cilës raportojnë njësitë administrative të saj, e konkretisht edhe punonjësja në fjalë.

Nisur nga sa më sipër, Administratori i njësisë ndministrative Baldushk, ka vepruar në tejkalim të kompetencave të tij, si rrjedhim, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë në fund të periudhës së provës dhe akti për moskonfirmimin e nëpunëses Lusiana Plaku, janë akte absolutisht të pavlefshme, referuar nenit 108, germa a), të pikës i), të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Në këto kushte, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit të sipërcituar këto akte nuk mund të sjellin pasoja juridike dhe nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vetë organi publik që ka nxjerrë aktet, që në këtë rast përkon me Administratorin e njësisë administrative Baldushk duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të moskonfirmimit nr. 1068, datë 27.6.2025 “Për moskonfirmimin si nëpunës civil”, për moskonfirmimin e nëpunëses Lusiana Plaku, si dhe të formularit të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës, për nëpunësen në fjalë.

Administratori i Njësisë Administrative në këtë rast, duhet të hartojë një relacion për nëpunësen L.Plaku, të cilin duhet t’ia drejtojë eprorit direkt të saj, ku të parashtrojë ecurinë e punonjësës që do të vlerësohet e më tej do të konfirmohet në fund të periudhës së provës, sipas këndvështrimit të tij, nisur nga sa ka konstatuar gjatë veprimtarisë së saj.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të nenit 108, germa a), pika i), 110 dhe 111 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, e Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Administratori i njësisë administrative Baldushk, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 1068, datë 27.6.2025 “Për moskonfirmimin si nëpunës civil”,

nëpërmjet të cilit ka vendosur të moskonfirmojë si nëpunëse civile punonjësen Lusiana Plaku, në përfundim të periudhës së provës dhe aktit të vlerësimit të punës.

2. Të përsëritet procesi i vlerësimit të punës për periudhën e provës për nëpunësen Lusiana Plaku, duke respektuar kërkesat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, ashtu si është evidentuar në pjesën arsyetuese të vendimit, duke përcaktuar qartë rolin e zyrtarëve vlerësues të ngarkuar me këtë proces.
3. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë institucionit të Bashkisë Tiranë, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për realizimin e veprimeve të mësipërme dhe njëkohësisht të verifikojë këtë proces edhe në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Tiranë, me qëllim unifikimin e tij.
4. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **30 ditë**, nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Të njoftohet për këtë vendim Njësia Administrative Baldushk; Bashkia e Tiranës; si dhe nëpunësja Lusiana Plaku.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha